

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

**UDHËZUES**

**MBI ZBATIMIN E DETYRIMEVE PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË  
PARAVE DHE PARANDALIMIN E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT  
TË BAZUAR NË RREZIKUN PP/FT.**

Mars 2022

## Pasqyra e lëndës

HYRJE .....	3
PASTRIMI I PARAVE DHE RREZIKU I FINANCIMIT TË TERRORIZMIT .....	3
VLERËSIMI I RREZIKUT .....	4
RREZIKU I KLIENTËVE .....	4
RREZIKU I PRODUKTEVE, SHËRBIMEVE DHE TRANSAKSIONEVE .....	5
RREZIKU NGA PRAKTIKAT E BIZNESIT DHE MËNYRAT E SHPËRNDARJES .....	5
RREZIKU GJEOGRAFIK .....	5
RREZIKU I LARTË PËR PASTRIMIN E PARAVE DHE FINANCIMIN E TERRORIZMIT .....	6
FAKTORËT QË NDIKOJNË NË RREZIKUN PP/FT .....	6
PRITSHMËRIA MBIKËQYRËSE – VLERËSIMI I RREZIKUT .....	7
ADMINISTRIMI I RREZIKUT .....	8
PRITSHMËRITË PËR MBIKËQYRJEN – REDUKTIMI I RREZIKUT PP/FT .....	8
MONITORIMI I RREZIKUT .....	9
PRITSHMËRIE MBIKËQYRËSE – MONITORIMI I RREZIKUT PP/FT .....	9
RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE NË DPPP .....	11
PRITSHMËRIA MBIKËQYRËSE – RAPORTIMI NË DPPP .....	11
SHTOJCA NR.1 – FORMULAR MODEL I VLERËSIMIT TË PËRGJITHSHËM TË RREZIKUT PP/FT .....	13
SHTOJCA NR.2. FORMULARI MODEL I VLERËSIMIT TË RREZIKUT PP/FT TË KLIENTIT .....	22
SHTOJCA NR.3 – MASAT E KONTROLLIT PËR PPP/FT .....	26

## Hyrje

Ky udhëzues synon t'u vijë në ndihmë Institucioneve Financiare dhe profesioneve jo-financiare (DNFBP)<sup>1</sup>, në zbatimin e një qasjeje të bazuar tek rreziku, lidhur me detyrimet për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizimit (PPP/FT). Udhëzimi ofron gjithashtu mjetet që mund të përdoren nga subjektet e ligjit nr.9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, i ndryshuar, për të kryer një vlerësim të rreziqeve të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizimit (PP/FT), për të hartuar dhe zbatuar masat me anë të të cilave administrohet dhe zvogëlohet ky rrezik.

## Pastrimi i Parave dhe Rreziku i Financimit të Terrorizimit

### Qasja me bazë rrezikun

Subjekteve të ligjit, ju kërkohet të zbatojnë një qasje të bazuar rrezikun PP/FT ndaj të gjitha hapave ligjore të duhur që merren për klientët. Një qasje me bazë rrezikun është një proces që u mundëson subjekteve raportuese, të identifikojnë rreziqe të larta potenciale për pastrim parash dhe financim të terrorizimit, si dhe që të zhvillojnë strategji për t'i administruar ato në mënyrë efektive.

Në situata ku është e nevojshme ndërmarrja e hapave të mëtejshëm, qasja e bazuar në rrezik, u mundëson subjekteve raportuese të përqendrojnë burimet aty në çështjet më prioritare, për të administruar rrezikun brenda nivelit të pranuar të tolerancës.

Në rastet kur nga subjektet identifikohen nivele të ulëta të rrezikut PP/FT, të justifikuara si duhet, institucionet financiare dhe DNFBP mund të marrin masa të “vigjilencës së thjeshtuar” për administrimin dhe zvogëlimin e këtyre rreziqeve.


Në funksion të administrimit dhe zvogëlimit të rreziqeve PP/FT, kërkohet që drejtuesit e nivelit të lartë, të angazhohen në zbulimin dhe parandalimin e PP/FT. Drejtuesit e nivelit të lartë kanë përgjegjësinë kryesore, për marrjen e vendimeve lidhur me politikën, procedurat, dhe proceset që ndikojnë në kontrollin dhe zvogëlimin e këtyre rreziqeve.

Zbatimi nga subjektet i masave për PPP/FT, duhet të jetë në përpjesëtim me shkallën e rrezikut dhe për këtë qëllim duhet të ndiqen hapat e paraqitur në diagramën e mëposhtme.

### Diagrami 1: Qasja me Bazë Risku

---

<sup>1</sup> (DNFBP) *Designated Non Financial Businesses and professions*



## Vlerësimi i rrezikut

Hapi i parë në qasjen me bazë rrezikun, është kryerja e një vlerësimi të rrezikut. Vlerësimi i rrezikut është analiza e kërcënimeve potenciale dhe pikave të dobëta në lidhje me PP/FT, më të cilat përballet subjekti. Komplexiteti i vlerësimit, varet nga përmasat dhe faktorët e riskut të aktivitetit të subjektit.

Në këtë kuadër subjektet duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë rrezikun sipas kategorive të mëposhtme:

- klientët;
- produktet, shërbimet dhe transaksionet;
- praktikat biznesi dhe mënyra e ofrimit;
- gjeografia;

## Rreziku i klientëve

Subjektet duhet të vlerësojnë natyrën e biznesit të klientëve të tyre për të përcaktuar nivelin e rrezikut për PP/FT, që nënkupton se për të bërë një vlerësim të riskut ata duhet të njohin klientët e tyre. Njohja e klientit nuk kufizohet vetëm në identifikimin dhe ruajtjen e të dhënave por ka të bëjë me të kuptuarin e veprimtarisë së tyre, rrjedhën e transaksioneve, mënyrën se si operojnë, si burimi i fondeve dhe i pasurisë së klientit, numri i transaksioneve të përfshira etj.

Vlerësimi individual i riskut për PP/FT është i detyrueshëm për secilin klient dhe duhet të kryhet nga subjektet kur krijohet një marrëdhënie biznesi apo dhe për transaksione rastësore.

Subjekti duhet që minimalisht të kategorizojë çdo klient me një vlerësim të ulët, mesatar ose të lartë. Në Shtojcën 2, është përgatitur një model formulari për vlerësimin e rrezikut, cili shërben për të orientuar punën e subjekteve në këtë proces. Vlerësimi i riskut duhet të dokumentohet nga subjekti dhe të shoqërohet më të dhënat përkatëse mbi bazën e të cilëve është përcaktuar niveli i rrezikut PP/FT. Për këtë qëllim mund të përdoret formulari i shtojcës apo dhe formularë të tjerë të hartuar nga vetë subjekti.

Frekuenca dhe shkalla e monitorimit tënd të vazhdueshëm të transaksioneve dhe marrëdhënies për secilin klient, duhet të përcaktohet nga vlerësimi i rrezikut të tyre i rrezikut. Klientët me rrezik më të ulët i nënshtrohen një mbikëqyrje minimale, ndërsa klientët me rrezik të mesëm dhe të lartë, i nënshtrohen një monitorimi më të plotë dhe të shpeshtë (shih seksionin 2.3.1 mbi monitorimin e rrezikut PP/FT).

### **Rreziku i produkteve, shërbimeve dhe transaksioneve**

Produktet dhe shërbimet që ofrohen nga subjektet raportuese mund të përdoren për të maskuar origjinën e fondeve të jashtëligjshme, për të transferuar fonde për financimin e akteve terroriste ose për të fshehur identitetin e vërtetë të klientit apo pronarit përfitues.

Subjektet, duhet të vlerësojnë rrezikun PP/FT të produkteve, shërbimeve dhe mënyrës së ofrimit të tyre. Produktet dhe shërbimet, që mundësojnë lëvizjen dhe konvertimin e fondeve dhe pasurive përmes sistemit financiar, mund të përbëjnë një rrezik të lartë. Përveç kësaj, subjektet duhet të marrin në konsideratë dhe faktorë të tjerë të riskut shërbimet e identifikuar nga rregullatorët, DPPPP ose burime të tjera të besueshme, duke qenë se përmbajnë rrezik potencial për pastrim parash ose financim terrorizmi.

### **Rreziku nga praktikat e biznesit dhe mënyrat e shpërndarjes**

Nga subjektet raportuese, kërkohet gjithashtu të shqyrtojnë mënyrat që përdoren për të ofruar produktet ose shërbimet e tyre. Në ekonominë e sotme dhe në tregun global, shumë prej mënyrave të shpërndarjes, nuk e sjellin klientin në kontakt të drejtpërdrejtë me subjektin (p.sh interneti, telefoni ose posta), dhe janë në çdo kohë të arritshëm nga kudo. Largësia e disa prej këtyre mënyrave të shpërndarjes, mund të përdoret gjithashtu për të fshehur identitetin e vërtetë të një klienti ose pronarëve përfitues, dhe për këtë arsye mund të paraqesë rreziqe më të mëdha PP/FT.

### **Rreziku gjeografik**

Subjektet duhet gjithashtu të shqyrtojnë nëse vendndodhjet gjeografike ku ato operojnë ose ndërmarrin aktivitetet e tyre, paraqesin rrezik potencialisht më të lartë për PP/FT. Në varësi të biznesit dhe operacioneve të tyre, vendndodhjet gjeografike mund të variojnë nga rrethinat e tyre të afërta, qofshin ato rurale apo urbane apo vende të tjera.

Lista e kontrollit në Shtojcën 1, paraqet një shembull orientues<sup>2</sup> për t'u përdorur nga subjektet, për të vlerësuar faktorët e mësipërm. Duhet theksuar fakti se vlerësimi i rrezikut të

---

<sup>2</sup> Subjektet mund ta përshtatin listën e kontrollit në përputhje me veçoritë e aktivitetit të tyre.

një subjekti, duhet t'i përshtatet kompleksitetit të aktivitetit të tyre dhe nevojave të tyre specifike të biznesit.

### **Rreziku i lartë për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit**

Ndonëse nuk ka një listë të pranuar gjerësisht të kategorive të rrezikut, shembujt e renditur në Shtojcën 1, të këtij udhëzimi janë ato që përdoren më shpesh. Këto rreziqe shërbejnë për të orientuar punën e subjekteve në përcaktimin e riskut PP/FT të transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit. Mbi bazën e këtij vlerësimi subjekti duhet të zbatojë masat përkatëse të kontrollit të rrezikut, të cilat duhet të përfshihen dhe në procedurat e tij të brendshme.

### **Faktorët që ndikojnë në rrezikun PP/FT**

Subjektet raportuese duhet të marrin parasysh veçoritë, shkallën e rrezikut ose dyshimit të një transaksioni ose një marrëdhënie biznesi me klientin. Në këtë kuadër, procedura e vlerësimit të rrezikut mund të përmbajë edhe rreziqe të ndryshueshme të cilat janë specifike për një klient ose kategori të caktuar biznesi. Ekzistenca e një ose më shumë faktorëve të mëposhtëm të riskut mund të diktojë nevojën e zbatimit të vigjilencës së zgjeruar, ose zbatimin e vigjilencës së duhur apo të thjeshtuar.

- natyra e një marrëdhënieje biznesi me një klient dhe ekzistenca e aktiviteteve specifike;
- niveli i legjislacionit apo i mbikëqyrjes nga organet kompetente. Për shembull, klientët që i nënshtrohen një sistemi të përshtatshëm të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfaqësojnë një rrezik më të ulët se klientët nga një industri ku ekziston rreziku i pastrimit të parave, sepse nuk ka kuadër rregullator me qëllim të parandalimit të këtyre veprimtarive;
- reputacioni dhe informacioni i publik për klientin.
- Personat ligjorë të cilët janë transparentë dhe të mirënjohur në rrafshin publik, që operojnë prej kohësh, të cilët nuk kanë qenë të përfshirë në çështje gjyqësore (p.sh për vepra penale që lidhen me pasurinë e fituar në mënyrë të paligjshme), paraqesin rrezik të ulët për pastrimin e parave;
- rregullsia apo kohëzgjatja e një marrëdhënieje biznesi;
- njohuri për vendin e klientit, duke përfshirë njohjen e ligjeve, rregulloreve dhe rregullave vendase, si dhe strukturën dhe fushën e veprimtimit të mbikëqyrjes rregullatore;
- proporcionaliteti ndërmjet madhësisë ose fushës së biznesit dhe jetëgjatësisë së të bërit biznes nga ana e klientit, duke përfshirë natyrën e shërbimit të kërkuar;
- distanca gjeografike e konsiderueshme ose e pashpjegueshme ndërmjet institucionit dhe klientit, kur kjo gjë nuk është e nevojshme;
- rreziqet që vijnë nga përdorimi i teknologjive të reja, që mundëson një marrëdhënie biznesi pa praninë e klientit dhe që favorizon anonimitetin;
- struktura e një klienti ose e një transaksioni. Strukturat që nuk kanë qëllime të qarta ligjore, tatimore, ekonomike apo qëllime të tjera ligjore, mundet ta shtojnë rrezikun.

## **Pritshmëria mbikëqyrëse – Vlerësimi i rrezikut**

Për të përcaktuar nëse një subjekt raportues ka zbatuar në mënyrën e duhur masat e vlerësimit të rrezikut, nga DPPPP vlerësohen kriteret e mëposhtme:

**Dokumentimi i vlerësimit të rrezikut** – Është e rëndësishme që vlerësimi i rrezikut PP/FT nga subjekti raportues, të jetë i dokumentuar. Kjo mundëson që strategjitë e vlerësimit të rrezikut të komunikohen me nivelin drejtues si dhe me punonjësit.

**Proporcionaliteti i vlerësimit të rrezikut** – Kujdes ju kushtohet dallimeve në praktikat, madhësinë, nivelin e zhvillimit dhe ekspertizës, mes subjekteve raportuese.

Për rrjedhojë, nga subjektet duhet që këtyre faktorëve t'u kushtohet vëmendje kur shqyrtohet vlerësimi i rrezikut PP/FT dhe strategjitë e zbutjes së rrezikut të subjektit raportues.

Vlerësimi i rrezikut mund të marrë forma të ndryshme në varësi të përmasave dhe aktivitetit të subjektit raportues. Një listë faktorësh rreziku, mund të jetë e përshtatshme për një subjekt të vogël, por për subjekte të mesme dhe të mëdha është e nevojshme që të hartohet një dokument më gjithëpërfshirës, që ndër të tjera përfshin dhe një matricë të rrezikut PP/FT.

## **Vlerësimi i rrezikut duhet të marrë parasysh elementët kryesorë të rrezikut**

Vlerësimi i rrezikut PP/FT të një subjekti, duhet të përbëhet minimalisht nga elementët e mëposhtëm:

- **Rreziku i klientit** – Subjekti raportues duhet të marrë në konsideratë natyrën dhe biznesin e klientëve të tij dhe marrëdhëniet e tyre të biznesit, për të përcaktuar nivelin e rrezikut të PP/FT. Shembuj të rrezikut të klientit janë përfshirë në Shtojcën 1, të udhëzuesit.
- **Produkti, shërbimet dhe transaksionet** - Një vlerësim i përgjithshëm i rrezikut, duhet të përfshijë përcaktimin e rreziqeve të mundshme që lidhen me produktet dhe shërbimet e ofruara nga subjekti raportues, duke theksuar se institucione të ndryshme raportuese ofrojnë një gamë të gjerë dhe të larmishme shërbimesh. Konteksti i shërbimeve që ofrohen është gjithmonë thelbësor për një qasje të bazuar në rrezik. Shembuj të rrezikut të produktit/shërbimit janë përfshirë në Shtojcën 1.
- **Praktikat e biznesit dhe mënyrat e ofrimit** – Subjekti raportues duhet të marrë në konsideratë rrugët e përdorura për të ofruar produktet dhe shërbimet e tij. Shumë mënyra ofrimi sigurohen pa pasur ndonjë kontakt të drejtpërdrejtë me klientin. Vëmendje duhet t'i kushtohet largësisë së mënyrës së ofrimit, pasi ato mund të përdoren gjithashtu për të fshehur identitetin e vërtetë të një klienti ose pronarit përfitues dhe për këtë arsye mund të paraqesin rreziqe më të larta PP/FT. Shembuj të rrezikut nga praktikat e biznesit dhe mënyrat e ofrimit janë përfshirë në Shtojcën 1 të udhëzuesit.
- **Rreziku gjeografik** – Subjekti raportues duhet të marrë parasysh nëse vendndodhja gjeografike në të cilat ai operon, ndërmerr aktivitete ose ku ndodhet një klient, paraqesin rrezik potencialisht më të lartë për PP/FT. Shembuj të rrezikut gjeografik janë përfshirë në Shtojcën 1 të udhëzuesit.

**Vlerësimi i rrezikut PP/FT duhet të miratohet nga drejtuesit e lartë.**

Angazhimi i drejtuesve të lartë në lidhje me PPP/FT, është një aspekt i rëndësishëm i aplikimit të qasjes me bazë rrezikun. Drejtuesit e lartë duhet të miratojnë vlerësimin e rrezikut PP/FT dhe të monitorojnë zbatimin e masave për zvogëlimin e rrezikut.

**Vlerësimi i rrezikut përditësohet në mënyrë periodike.** Drejtuesit e lartë duhet të sigurojnë që vlerësimi i rrezikut PP/FT të rishikohet periodikisht. Subjekti raportues është përgjegjës për përcaktimin e shpeshtësisë së duhur të përditësimit të vlerësimit të rrezikut duke marrë parasysh hyrjen në fuqi të legjislacionit dhe rregulloreve të reja, aktiviteti në tregje të reja, ndryshimet në profilin e rrezikut të klientit dhe prezantimin e produkteve dhe shërbimeve të reja. Nëse asnjë faktor i jashtëm nuk është shkak për përditësim, vlerësimi i rrezikut duhet të përditësohet të paktën çdo dy vjet.

**Një vlerësim rreziku kryhet për çdo klient.** Kur vendoset një marrëdhënie biznesi me klientin, duhet që ai t'i nënshtrohet një vlerësimi të rrezikut PP/FT. Vlerësimi i rrezikut duhet të dokumentohet dhe të përfshijë një kategorizim të argumentuar. Vlerësimi i rrezikut të klientit, duhet të përditësohet periodikisht. Një formular model për vlerësimin e rrezikut të klientit, mund ta gjeni në Shtojcën 2 të udhëzuesit.

**Një vlerësim rreziku kryhet për produkte, praktika biznesi ose teknologji të reja.** Vlerësimi i rrezikut duhet të kryhet përpara prezantimit të produktit të ri, praktikës së re të biznesit ose teknologjisë së re, si për produktet e reja ashtu edhe për ato ekzistuese. Ky vlerësim duhet të dokumentohet dhe të vihet në dispozicion DPPP ose autoritetit mbikëqyrës, sipas kërkesës.

**Personat përgjegjës për PPP/FT janë në dijeni të rezultateve të vlerësimit të rrezikut.** Që një kuadër i menaxhimit të rrezikut PP/FT të jetë efektiv, personat përgjegjës dhe punonjësit në përgjithësi, duhet të jenë të vetëdijshëm për rreziqet PP/FT me të cilat përballet subjekti. Trajnimi i punonjësve duhet të përfshijë një përmbledhje të vlerësimit të rrezikut dhe masave për administrimin e tyre sa më efektiv.

### **Administrimi i rrezikut**

Administrimi i rreziqeve PP/FT, të identifikuar nga subjekti raportues, ka të bëjë me zbatimin e masave për kufizimin duke qëndruar brenda nivelit të pranueshëm të tolerancës. Në rastet kur në vlerësimin e rrezikut PP/FT, subjekti identifikon rreziqe të larta për PP ose FT, ai duhet të hartojë dhe dokumentojë një strategji për administrimin e tyre që shoqërohet dhe me masat parandaluese konkrete (p.sh politika dhe procedura që synojnë reduktimin e rrezikut). Shtojca 2 e udhëzuesit, ofron një listë orientuese të masave për administrimin e rrezikut që mund të ndërmerren nga subjektet raportuese.

### **Pritshmëritë për mbikëqyrjen – reduktimi i rrezikut PP/FT**

Për të përcaktuar nëse një subjekt raportues, ka zbatuar në mënyrë adekuate masa për zbutjen e rrezikut, DPPP merr në konsideratë dhe vlerëson kriteret e mëposhtme:



**Dokumentimi i strategjisë së administrimit të rrezikut PP/FT.** Është e rëndësishme që strategjia e administrimit të rrezikut e hartuar nga subjekti të dokumentohet. Një hap i tillë mundëson njohjen me të të personave përgjegjës për PPP/FT dhe punonjësve të tjerë sipas funksioneve që ata kanë në aktivitetin e subjektit.

**Zbatimi i strategjisë për administrimin e rrezikut.** Strategjia duhet të dokumentohet dhe efektiviteti i zbatimit të masave përkatëse duhet të vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme nga drejtuesit dhe personi përgjegjës i subjektit.

**Rishikimi i strategjisë.** Një aspekt i rëndësishëm i zbatimit të qasjes me bazë rrezikun PP/FT, është angazhimi në këtë proces i nivelit drejtues të subjektit, të cilët janë përgjegjës për miratimin dhe zbatimin e saj. Ky dokument duhet të rishikohet të paktën çdo 2 vjet, ose dhe më shpesh në rastet të ndryshimeve të ndjeshme (p.sh. në nivelin e aktivitetit ose në profilin e klientëve të subjektit).

**Personat përgjegjës dhe punonjësit e subjektit janë të vetëdijshëm për masat që duhet të zbatohen, për administrimin e rrezikut PP/FT.** - Kjo do të bëjë të mundur që punonjësit të zbatojnë masat për administrimit të rrezikut të vendosura nga drejtuesit e lartë. Në këtë kuadër është e rëndësishme që punonjësit e subjektit, të informohen në vijimësi për rreziqet dhe funksionet që ata duhet të përmbushin në funksion të parandalimit të PP/FT.

### **Monitorimi i rrezikut**

Përveç vlerësimit të rrezikut dhe aktiviteteve për administrimin e tij, subjekteve raportuese ju kërkohet gjithashtu, të marrin masa për të kryer monitorim të vazhdueshëm të transaksioneve dhe marrëdhënies së biznesit. Niveli i monitorimit duhet të përshtatet sipas rreziqeve të PP/FT, të përcaktuara në vlerësimin e rrezikut të subjektit. Qëllimi i aktiviteteve të vazhdueshme të monitorimit, është të ndihmojë në zbulimin e aktiviteteve të dyshimta.

Politikat, kontrollet dhe procedurat e brendshme të subjektit raportues, duhet të përcaktojnë llojin e monitorimit bazuar në nivelin e rrezikut, duke përfshirë dhe identifikimin e zbulimit të aktiviteteve të dyshimta për PP/FT. Ato duhet gjithashtu të përcaktojnë afatet e rishikimit të tyre, shpeshtësinë e kryerjes së monitorimit të transaksioneve dhe marrëdhënies së biznesit dhe efektivitetin e zbatimit të tyre.

### **Pritshmërie mbikëqyrëse – Monitorimi i rrezikut PP/FT**

Për të përcaktuar nëse një subjekt raportues, ka zbatuar apo jo në mënyrë adekuate masat e monitorimit të rrezikut, DPPP ndërr të tjera merr në konsideratë kriteret e mëposhtme:

**Monitorimin e marrëdhënies së biznesit.** Ky monitorim, duhet të kryhet në baza të ndjeshmërisë ndaj rrezikut PP/FT. Më konkretisht, subjektet raportuese do të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme të gjitha transaksionet<sup>3</sup> komplekse, të pazakonta, të dyshimta ose në vlera të larta, si dhe transaksionet që nuk kanë ndonjë qëllim të dukshëm ekonomik ose të ligjshëm.

---

<sup>3</sup> Të kryera ose në tentative.

**Aktivitetet e monitorimit përfshijnë qëllimin e marrëdhënies së biznesit dhe burimin e fondeve.** Gjatë kryerjes së monitorimit të vazhdueshëm, subjekti raportues duhet t'i referohet qëllimit të marrëdhënies së biznesit dhe burimit të synuar të fondeve që është dokumentuar në fillim të marrëdhënies së biznesit, për të garantuar që transaksionet dhe shërbimet e ofruara përkojnë me atë që është deklaruar nga klienti.

**Dokumentimi i ndryshimeve të pajustificuara ose jonormale në aktivitetet e klientit tuaj.** Subjektet duhet të vlerësojnë ndryshimet në aktivitetin e klientit, të cilat nuk përputhen me modelet normale të transaksioneve ose marrëdhënieve me klientë të ngjashëm. Subjekti gjithashtu duhet të përcaktojë procedurën konkrete, që mundëson raportimin nga punonjësit tek personi përgjegjës PPP/FT, të çdo informacioni të konstatuar në kuadrin e këtij monitorimi.

**Vendosja e parametrave të monitorimit.** Institucionet raportuese duhet të përcaktojnë treguesit në lidhje me transaksionet dhe marrëdhëniet e biznesit, të cilat do të përbënin sinjale paralajmëruese dhe që do të kërkonin rishikim të detyrueshëm nga personi përgjegjës. Këta tregues, duhet të bazohen tek informacionet mbi rreziqet e PP/FT të aktivitetit tuaj.

**Transaksionet ose marrëdhëniet me rrezik më të lartë monitorohen më shpesh.** Institucionet raportuese shqyrtojnë më shpesh transaksionet me rrezik të mesëm apo të lartë, të cilët përputhen me treguesit e aktivitetit të dyshimtë të lidhur me marrëdhëniet e biznesit, si dhe i përshkallëzojnë ato nëse zbulohen tregues shtesë.

**Raporti i aktivitetit të dyshimtë (RAD).** Qëllimi i monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit është identifikimi i aktiviteteve të dyshimta për PP/FT. Transaksionet që identifikohen nga subjektet si të dyshimta gjatë aktiviteteve të monitorimit, duhet të fillimisht t'i nënshtrohen një procesi analizimi nga personi përgjegjës PPP/FT dhe nëse dyshimet konfirmohen atëherë raporti RAD duhet të dërgohet në DPPPP. Numri i RAD të një subjekti raportues, shërben si një nga treguesit e efikasitetit të programit të tij parandalues<sup>4</sup>.

**Të identifikohen transaksionet komplekse, me vlerë të lartë dhe të pazakonta.** Subjektet raportuese, duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve komplekse, në vlera të larta, të pazakonta dhe pa një qëllim të qartë ekonomik ose ligjor.

Ajo që konsiderohet komplekse, me vlerë të lartë dhe e pazakontë, do të jetë unike për operationet dhe sektorin specifik të aktivitetit të subjektit raportues. Për të përcaktuar nëse një transaksion është në vlera të larta, duhet të bazoheni në kategoritë e klientëve tuaj, aktivitetin, vlerat mesatare të transaksioneve, shërbimet që ofroni si dhe madhësinë e biznesit. Transaksionet komplekse, shpesh përdoren për të fshehur burimin e fondeve dhe pasurisë të klientëve që kryejnë transaksionin. Transaksionet e pazakonta konsiderohen transaksionet që nuk përkrijnë me praktikën normale të aktivitetit tuaj apo të klientit, ose që ju i konsideroni jo tipike bazuar në njohuritë tuaja për sektorin ku veproni. Ato përfshijnë, transaksione që nuk janë pjesë e aktivitetit normal të klientit dhe mund të përfshijnë, pagesën e një sasive të madhe parash në një llogari karte krediti, shkëmbimi i një shume të madhe në para në një monedhë tjetër ose shkëmbimi i kartëmonedhave me vlerë të ulët me ato me vlerë të lartë.

---

<sup>4</sup> Analiza sasiore e numrit të RAD të raportuara, është një nga treguesit e efektivitetit të programit parandalues PP/FT të një subjekti, pasi duhet të merret në konsideratë nivelet e ndryshme të rrezikut të PP/FT, brenda dhe të njëjtit sektor të subjekteve raportuese.

## **Dokumentimi i analizës së historikut dhe qëllimit të transaksioneve.**

Subjektet raportuese duhet gjithashtu të analizojnë qëllimin e kryerjes së transaksioneve komplekse, të pazakonta, komplekse që nuk përkojnë me profilin e rrezikut PP/FT të klientit, dhe të dokumentojë këto analiza.

## **Raportimi i transaksioneve në DPPP**

Institucioni raportues është i detyruar të paraqesë në DPPP një Raport të Aktivitetit të Dyshimtë (RAD), menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë nga momenti i konstatimit të dyshimit për PP/FT. Kjo kërkesë zbatohet si për transaksionet e përfunduara ashtu edhe për ato në tentativë.

DPPP kërkon që institucioni raportues që paraqet RAD, t'i japë atij të dhënat e çdo çështjeje në lidhje me dyshimin me të cilin lidhet raporti dhe arsyet mbi të cilat ai bazohet.

## **Pritshmëria mbikëqyrëse – Raportimi në DPPP**

**Raportet e aktiviteteve të dyshimta raportohen pa asnjë vonesë.** Subjekti raportues duhet t'i raportojë DPPP-së veprimtaritë ose transaksionet e dyshimta që tregojnë aktivitete të mundshme PP/FT. Në rastet që lidhen me financimin e terrorizmit ose çështjet e sigurisë kombëtare, informacioni duhet të transmetohet menjëherë.

**RAD raportohen në mënyrën e përcaktuar.** Duhet bërë i ditur informacioni i mjaftueshëm i cili të tregojë natyrën dhe arsyen e dyshimit, dhe kur institucioni raportues ka dokumentacion mbështetës shtesë, ai duhet gjithashtu të vihet në dispozicion. Të gjitha fushat e detyrueshme në formularin RAD duhen plotësuar.

**RAD-të shoqërohen me kopje të të gjithë dokumentacionit që lidhet me dyshimin.** Kjo përfshin informacionin e hapave ligjorë të ndjekur të klientit, kopjen e kontratës (nëse është e rëndësishme), historinë e transaksionit si dhe arsyet mbi të cilat bazohet dyshimi.

**Subjekti raportues u përgjigjet në kohën e duhur kërkesave të bëra nga DPPP.** Kur një institucion raportues merr një kërkesë informacioni nga DPPP, institucioni duhet t'i japë DPPP-së të dhënat e kërkuara ose të dhënat e mëtejshme dhe kopjet e dokumenteve deri në masën kur këto të dhëna ose dokumente të jenë të disponueshme për atë klient.

**Subjekti raportues nuk sinjalizon se një RAD është raportuar.** Institucioni raportues nuk duhet t'ia zbulojë një personi të paautorizuar dyshimin për PP.

**Raportet e aktiviteteve të dyshimta përfshijnë tregues të PP/FT.** Raportet e aktiviteteve të dyshimta duhet të përfshijnë një listë të treguesve që e shtynë institucionin raportues të besojë se aktiviteti ka të bëjë me PP/FT. DPPP publikon një listë të treguesve të PP/TF që mund të referohen për këtë qëllim.

**Raportet e aktivitetit të dyshimtë përfshijnë një përshkrim të detajuar të dyshimit.**

Raporti RAD duhet të përfshijë arsyet tuaja për dyshime dhe rezultatet e vlerësimit tuaj të fakteve, kontekstit dhe treguesve të PP/TF për klientin, të cilat çuan në vendimin tuaj për të paraqitur këtë raport në DPPP. Disa nga detajet të këtij raporti mund të përfshijnë:

- informacion identifikues;
- historikun që klienti ka me ju;
- kur besoni se filloi PP/TF;
- detajet e transaksionit;
- lidhjet me individë, biznese dhe llogari të tjera;
- informacion mbi pronësinë, kontrollin dhe strukturën e klientit;
- qëllimin e marrëdhënies së biznesit, aktivitetin që keni vëzhguar;
- çdo informacion publik të konsultuar për këtë qëllim;

## **Shtojca Nr.1 – Formular model i vlerësimit të përgjithshëm të rrezikut PP/FT**

**Emri i subjektit raportues:** \_\_\_\_\_

**Periudha e vlerësimit të rrezikut:** \_\_\_\_\_

Bazuar në Ligjin nr.9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” I ndryshuar, subjekteve ju kërkohet të kryejnë një vlerësim të rrezikut të ekspozimit ndaj PP/FT, si dhe të zbatojnë masat dhe kontrollat përkatëse. Kjo listë kontrolli ka për qëllim t’ju ndihmojë në përmbushjen e këtyre detyrimeve. Ky formular është paraqitur vetëm si shembull orientues dhe subjektet mund të përdorin metodologji dhe formular të tjerë, të cilët i përshtaten aktivitetit të tyre.

Udhëzime: Rishikoni klientët me rrezik më të lartë dhe situatat e përshkruara në kolonën e majtë, dhe përcaktoni nëse i keni kryer këto veprimtari gjatë periudhës të vlerësimit të rrezikut. Në kolonën e caktuar, duhet të pasqyrohet shpeshësia e secilit lloj transaksioni. Kur i përgjigjeni me “po” njëres prej pyetjeve, ajo situatë ose klient konsiderohet me rrezik më të lartë dhe rrjedhimisht për të duhet të zbatohet masa kontrolli, me të cilat synohet ulja e nivelit të rrezikut PP/FT. Për çdo klient apo situatë me rrezik më të lartë, propozohet një masë kontrolli, ndërkohë që subjektet mund t’i përshtatin ato me natyrën e aktivitetit të tyre (për listën e masave të kontrollit shih Shtojcën 3).

Rezultatet e këtij vlerësimi të rrezikut, duhet të integrohen në politikat dhe procedurat e subjekteve raportuese. Në zhvillimin e politikave dhe procedurave që përshtaten me rezultatet e gjetjeve të vlerësimit të rrezikut, subjektet raportuese duhet të marrin parasysh shpeshësinë dhe nivelin e transaksioneve me rrezik më të lartë. Subjekti duhet t’u japë përparësi monitorimit dhe masave të kontrollit të transaksioneve apo marrëdhënieve me rrezik të mesëm apo të lartë për PP/FT, pa lënë jashtë vëmendjes dhe ato me rrezik të ulët.

Në këto masa subjekti raportues duhet të përfshijë gjithashtu dhe komunikimin me punonjësit, për të siguruar që ata i kuptojnë në mënyrë adekuate këto rreziqe dhe masat e kontrollit që duhet të zbatohen. Trajnimi i punonjësve përkatës, duhet të përfshijë një prezantim të vlerësimit të rrezikut dhe rolit të punonjësve në zbatimin e masave të kontrollit. Subjektet duhet të rishikojnë vlerësimin e rrezikut në mënyrë periodike (çdo dy vjet) ose më shpesh nëse një gjë e tillë diktohet nga ndryshimet në legjislacionin PPP/FT ose aktivitetin e tyre.

## Vlerësimi i rrezikut

Klientë dhe situata me rrezik më të lartë për PP/FT	Po Rrezik më i lartë	Jo	Frekuenca e transaksioneve (i lartë, i moderuar, i ulët, pa transaksione)	Masat e propozuara të kontrollit
<b>Klientë</b>				
A janë klientët tuaj persona jo-rezidentë?			•	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcaktoni nëse individët janë persona të ekspozuar politikisht.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Të kryhet kërkim në internet</li> <li>• Të rritet shpeshtësia e monitorimit të vazhdueshëm</li> </ul>
A keni klientë që janë persona të ekspozuar politikisht?			•	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni miratimin e drejtuesve të lartë për të kryer transaksionin.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Monitoroni çdo transaksion të ardhshëm.</li> </ul>
A është struktura e pronësisë së klientit tuaj komplekse, gjë që e bën të vështirë përcaktimin e pronarit përfitues?			•	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sigurohuni për identifikimin dhe verifikimin e pronarit përfitues të kompanisë, fondacionit, OJF apo trustit.</li> <li>• Merrni informacion shtesë mbi strukturën e pronësisë së subjektit.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> </ul>

<p>A ka informacione nga burimet e hapura që tregojnë për përfshirjen e klientit tuaj në aktivitete të jashtëligjshme?</p>			<ul style="list-style-type: none"> <li>•</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizoni informacionin dhe shqyrtoni mundësinë e dërgimit të Raportit të Aktivitetit të Dyshimtë në DPPPP.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> </ul>
<p>A keni një klient që po kryen një transaksion që nuk justifikohen nga puna, profesioni apo të ardhurat e deklaruara?</p>			<ul style="list-style-type: none"> <li>•</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> </ul>
<p>A përfshihen klientët tuaj në transaksione apo aktivitete që janë në përputhje me treguesit apo tipologjitë për PP/FT?</p>			<ul style="list-style-type: none"> <li>•</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizoni informacionin dhe shqyrtoni mundësinë e paraqitjes së një Raportit të Aktivitetit të Dyshimtë në DPPPP.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> </ul>
<p><b>Rreziku gjeografik</b></p>				
<p>A është ndonjë nga klientët tuaj ose burimet e fondeve, me origjinë nga vende që i nënshtrohen sanksioneve, embargove ose masave të ngjashme të lëshuara nga Shqipëria ose organizata ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara (“OKB”)?</p> <p>Organizata e Kombeve të Bashkuara:  <a href="https://www.un.org/sc/suborg/en/sanctions/un-sc-consolidated-list">https://www.un.org/sc/suborg/en/sanctions/un-sc-consolidated-list</a></p>			<ul style="list-style-type: none"> <li>•</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni miratimin e nivelit drejtues për të vazhduar me transaksionin.</li> <li>• Kërkoni dokument shtesë identifikimi për të verifikuar identitetin.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Shtoni shpeshësinë e monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit.</li> </ul>

<p>Lista e personave të shpallur si financues të terrorizmit e publikuar në faqen zyrtare të DPPPP: www.fiu.gov.al</p>				
<p>A është ndonjë nga klientët tuaj ose burimet e fondeve, me origjinë nga vende të identifikuara si parajsë fiskale apo vende në të cilat aplikohet sekreti bankar?</p>			<ul style="list-style-type: none"> <li>•</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni miratimin e drejtuesve të lartë për të vazhduar me transaksionin.</li> <li>• Kërkoni një dokument shtesë identifikimi për të konfirmuar identitetin.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Shtoni shpeshhtësinë e monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit.</li> </ul>
<p>A është ndonjë nga klientët tuaj ose burimet e fondeve të tyre me origjinë nga vende të identifikuara nga Task Forca e Veprimit Financiar (FATF) si me mangësi strategjike në luftën kundër pastrimit të parave ose që i nënshtrohen një deklaratë të TFVF-së? TFVF: <a href="http://www.fatf-gafi.org/publications/high-riskandnon-cooperativejurisdictions/?hf=10&amp;b=0&amp;s=desc(fatf_releasedate)">http://www.fatf-gafi.org/publications/high-riskandnon-cooperativejurisdictions/?hf=10&amp;b=0&amp;s=desc(fatf_releasedate)</a></p>			<ul style="list-style-type: none"> <li>•</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni miratimin e drejtuesve të lartë për të vazhduar me transaksionin apo marrëdhënien e biznesit.</li> <li>• Kërkoni një dokument shtesë për të verifikuar identitetin e klientit.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Shtoni shpeshhtësinë e monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit.</li> </ul>



<p>A është ndonjë nga klientët tuaj ose burimet e fondeve, me origjinë nga vende të identifikuar nga burime të besueshme si financim ose mbështetje për veprimtari terroriste?</p>			<ul style="list-style-type: none"> <li>•</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni miratimin e drejtuesve të lartë për të vazhduar me transaksionin apo marrëdhënien e biznesit.</li> <li>• Kërkoni një dokument shtesë për të verifikuar identitetin e klientit.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Shtoni shpeshtësinë e monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit.</li> </ul>
<p>A është ndonjë nga klientët tuaj ose burimet e fondeve, me origjinën nga vende të identifikuar nga burime të besueshme se kanë nivele të konsiderueshme korrupsioni ose aktivitete të tjera kriminale? <a href="http://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2016">http://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2016</a></p>			<ul style="list-style-type: none"> <li>•</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni miratimin e drejtuesve të lartë për të vazhduar me transaksionin.</li> <li>• Kërkoni një dokument shtesë për të verifikuar identitetin e klientit.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> </ul>
<b>Mënyra e ofrimit të shërbimeve dhe praktikat e biznesit</b>				
<p>A pranoni pagesa me para në dorë?</p>			<ul style="list-style-type: none"> <li>•</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni informacion mbi burimin e fondeve të klientit.</li> <li>• Vendosni kufij maksimal për shumat e transaksioneve me para në dorë.</li> </ul>

A kryeni transaksione pa praninë fizike të klientit?			•	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryeni rishikimin periodik të të dhënave për të siguruar që kërkesat ligjorë ndaj klientit janë zbatuar në mënyrë adekuate.</li> <li>• Ofroni për personat përgjegjës, trajnime gjithëpërfshirëse për PPP/FT, të përqëndruar veçanërisht në kërkesat procedurale ndaj klientit.</li> <li>• Kërkoni një dokument shtesë për të verifikuar identitetin e klientit.</li> </ul>
A keni klientë që ju referohen nga një palë e tretë?			•	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryeni rishikim periodik të të dhënave për tu siguruar që palët e treta të respektojnë kërkesat e kujdesit të duhur ndaj klientit.</li> </ul>
A ndërmerrni transaksione me vlerë të lartë <sup>5</sup> , komplekse apo të pazakonta?			•	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kushtojini vëmendje të veçantë treguesve PP/FT që lidhen me këto transaksione.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Shtoni shpeshtësinë e monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit.</li> </ul>
<b>Faktorë të tjerë rreziku: (renditni ndonjë faktor shtesë që ka të bëjë me aktivitetin tuaj)</b>				

<sup>5</sup> Përcaktohen nga çdo subjekt në bazë të vlerave mesatare të transaksioneve dhe veçorive të tjera të klientëve dhe shërbimeve që ofron.

Produkti, Shërbimet dhe Transaksionet				
Produkte, shërbime dhe transaksione me rrezik më të lartë	Po Rrezik më i lartë	Jo		Masat e kontrollit
A ofroni produkte apo shërbime që kanë tipare anonimiteti?			•	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërmerr procedura të mëtejshme verifikimi për klientin ose pronarin përfitues.</li> </ul>
A ofroni produkte ose shërbime në nivel ndërkombëtarë (p.sh. transferime parash në internet, karta të parapaguara, dërgesa parash, transfertat ndërkombëtarë parash me telefon celular, gurë apo metale të çmuara, etj)?			•	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcaktoni nëse klientët janë persona të ekspozuar politikisht.</li> <li>• Përcaktoni nëse vëndi i destinacionit konsiderohet me rrezik të lartë.</li> <li>• Shtoni shpeshtësinë e monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit.</li> </ul>

A ofroni produkte komplekse ku është e vështirë të identifikohet pronari përfitues?			•	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërmerr procedura të mëtejshme verifikimi për klientin ose pronarin përfitues</li> </ul>
A ofroni shërbime që lejojnë shkëmbimin e parave me një instrument të negociueshëm të mbajtësit (p.sh. karta të papaguara, çeqe të udhëtarit, etj)?			•	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve</li> <li>• Shtoni shpeshtësinë e monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit.</li> </ul>
A jeni i përfshirë në transaksione të pasurive të paluajtshme me vlerë të lartë <sup>6</sup> ?			•	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kushtojini vëmendje të veçantë treguesve të transaksioneve të pazakonta dhe PP/FT.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Të rritet shpeshtësia e monitorimit të vazhdueshëm.</li> </ul>
<b>Faktorë të tjerë:</b> Subjektet duhet të renditin produktet/shërbimet që konsiderohen me rrezik të lartë në sektorin e tyre, siç përcaktohet nga analiza e tyre e rrezikut ose vlerësimi kombëtar				

<sup>6</sup> Përcaktohen nga çdo subjekt në bazë të vlerave mesatare të pasurive të paluajtshme për zonën përkatëse ku ndodhet pasuria.

<b>i rrezikut.</b>				
--------------------	--	--	--	--

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi i personit përgjegjës për PPP/FT

Data\_\_\_\_\_

Data e trajnimit të punonjësve: \_\_\_\_\_

## Shtojca Nr.2. Formulari model i vlerësimit të rrezikut PP/FT të klientit

Si pjesë e detyrimeve për vlerësimin e rrezikut PP/FT, subjektet duhet të bëjnë dhe një vlerësim të secilit prej klientëve. Ky formular i vlerësimit të rrezikut, ka për qëllim të orientojë punën e subjekte në përmbushjen e këtij detyrimi.

*Udhëzime:* Rishikoni klientët me rrezik më të lartë dhe situatat e përshkruara në kolonën e majtë dhe tregoni nëse ndonjë nga këto situata vlen për klientin tuaj. Ju duhet të tregoni shpeshësinë e secilit lloj transaksioni në kolonën e caktuar. Sa më shumë faktorë rreziku të identifikoni për një klient, aq më i lartë është rreziku me të cilin kategorizohet ai. Pasi të keni plotësuar formularin, duhet që për çdo klient të bëhet kategorizimi i riskut PP/FT. Në fund të formularit përcaktohet dhe niveli i rrezikut PP/FT të klientit.

Rezultatet e vlerësimit të rrezikut të klientit tuaj, shërbejnë për të përcaktuar shpeshësinë dhe intensitetin e mbikëqyrjes së transaksioneve apo marrëdhënies së biznesit dhe vendimmarrjen për zbatimin e kontrolleve shtesë.

<b>Klientë dhe situata me rrezik më të lartë</b>	<b>Po</b> Rrezik më i lartë	<b>Jo</b>	<b>Shpeshësia e transaksioneve</b> (e lartë, e mesme, e ulët)	<b>Informacione shtesë që mund të ndikojnë në rrezikun e klientit</b>
	<b>Klientët</b>			
A është i huaj klienti person jo-rezident?				•
A është klienti juaj person i ekspozuar politikisht?*				•
A është klienti juaj një person juridik me strukturë komplekse të pronësisë përfutuese?				•
A është klienti juaj OJF?				•

A është i panjohur burimi i fondeve të klientit tuaj?			•	•
A është e pazakontë shpejtësia, vëllimi ose shpeshtësia e transaksioneve për klientin?			•	•
A ka ndonjë informacion publik që lidh klientin tuaj ndonjë aktivitetin të jashtëligjshëm?			•	•
A ka klienti juaj precedent penal?*			•	•
A përdor klienti juaj një nivel të lartë të transaksioneve me para në dorë?			•	•
A po kryen klienti juaj një transaksion që nuk është në përputhje me deklarin e tij mbi punën apo të ardhurat?			•	•
A angazhohet klienti juaj në veprimtari që përputhen me treguesit apo tipologjitë e identifikuar për aktivitete të dyshimta të PP/FT?			•	•
A ka klienti juaj ose burimet e fondeve të tij/saj origjinë nga vende të identifikuara nga Task Forca e Veprimit Financiar (FATF) si me mangësi strategjike në luftën kundër pastrimit të parave apo				

<p>subjekt i një deklaratë të TFVF-së?</p> <p>TFVF: <a href="http://www.fatf-gafi.org/publications/high-riskandnon-cooperativejurisdictions/?hf=10&amp;b=0&amp;s=desc(fatf_releasedate)">http://www.fatf-gafi.org/publications/high-riskandnon-cooperativejurisdictions/?hf=10&amp;b=0&amp;s=desc(fatf_releasedate)</a></p>				
<p>A janë klienti juaj ose fondet e tij nga vende të identifikuar prej burimesh të besueshme, se ofrojnë fonde ose mbështetje për veprimtari terroriste?</p>				
<p>A është klienti juaj ose burimet e fondeve, me origjinë nga vende të identifikuar prej burimesh të besueshme me nivele të konsiderueshme korrupsioni ose aktivitete të tjera kriminale?</p> <p><a href="http://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2016">http://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2016</a></p>				



**VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RREZIKUT PP/FT TË KLIENTIT:**

**Shkalla e propozuar e rrezikut:**

<b>Rrezik i lartë</b> 4 faktorë rreziku ose frekuencë e lartë e disa faktorëve të rrezikut ose faktorë rreziku që janë të shënjuar me *.	<b>Rrezik i mesëm-i lartë</b> 3 faktorë rreziku ose frekuencë e lartë e një faktorit rreziku	<b>Rrezik i mesëm</b> 2 faktorë rreziku ose frekuencë e moderuar e një faktorit rreziku	<b>Rrezik i mesëm-i ulët</b> 1 faktor rreziku	<b>Rrezik i ulët</b> Pa faktorë rreziku
---	---	--	--	--

### **Shtojca Nr.3 – Masat e kontrollit për PPP/FT**

1. Merrni miratimin e drejtuesve të lartë ose personit përgjegjës PP/FT për të vazhduar me kryerjen e transaksionit.
2. Merrni dhe vërtetoni informacionin identifikues shtesë.
3. Merrni emrin e personit (ave) që qëndron pas korporatës, trustit ose marrëveshjes ligjore.
4. Të shtohet shpeshësia e monitorimit të vazhdueshëm.
5. Të merret informacion mbi burimin e fondeve ose burimin e pasurisë së klientit.
6. Ofroni trajnime më të shpeshta të punonjësve.
7. Të monitorohen ndryshimet legjislative dhe rregullatore.
8. Përfshini detyrimet e PP/FT në përshkrimet dhe vlerësimin e punës së punonjësve.
9. Vendosni kufij për shumat e transaksioneve me para në dorë.
10. Kërkoni pagesën me çek në vend që të pranoni pagesa me para në dorë.
11. Kryeni transaksione vetëm me paraqitje fizike të klientit.
12. Merrni informacionin e duhur shtesë për të kuptuar biznesin ose rrethanat e klientit.
13. Kryeni një kërkim në internet për klientin.
14. Ndërmerr procedura të mëtejshme verifikimi për klientin ose pronarin përfitues.
15. Merrni informacionin e autorit dhe të përfituesit
16. Përcaktoni nëse vendi i destinacionit të transaksioneve apo marrëdhënieve të biznesit, konsiderohet me rrezik të lartë.